




Partneritetet e Qëndrueshme Komunale
Partnerstvo održivog razvoja jedinica lokalne samouprave
Партнерство одрживог развоја јединица локалне самоуправе
Kommunale Nachhaltigkeitspartnerschaften

SERVICESTELLE 
KOMMUNEN IN DER EINEN WELT



MATERIALI

WORKSHOPI NDËRKOMBËTAR I PROJEKTIT
„PARTNERITETET E QËNDRUESHME KOMUNALE“

16 deri me 17 Janar 2017 në Gelsenkirchen | Nr. 92

Qendra e shërbimit Komunitat në Njërin Botë (SKEW)

info@service-eine-welt.de

www.service-eine-welt.de

Materiali – Radha e shkresave e Qendrës së Shërbimit të Komunitave në Njërin Botë (SKEW), Fletorja 92

Përgjegjës për përmbajtjen: SKEW, Dr. Stefan Wilhelmy

Drejtuesit e projektit: Isabela Santos de Albuquerque Nunes Koletzke dhe Vera Strasser

Tekstet: Stefanie Wulff

Redaksia: Vera Strasser, Eva Heuschen

Fotografi: Barbara Frommann

Layout, formulimi dhe organizimi i printimit: Fabian Ewert, Königswinter

Bon, Gusht 2017

Ri-shtypje, edhe pjesërisht, vetëm me miratim paraprak të botuesit. Seria „Material“ mbështetet financiarisht nga ana e Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim si dhe nga landet federale të Baden-Württemberg, Bremen, Hamburg, Nordrhein-Westfalen dhe Rheinland-Pfalz.

Për të lehtësuar leximin, mënyra normale e të shkruarit për barazinë e gjinisë mashkullore dhe asaj femërore në këtë publikim nuk janë përdorur gjatë gjithë kohës. Te të gjitha emërtimet mashkullore janë të përfshira natyrisht në të njëjtën mënyrë edhe gjinia femërore (ose anasjelltas).

Kontributet e përmendura me emër nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimin e botuesit dhe redaktorit.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Workshop-i i parë – Dita e 1-rë	5
2.1. Hapja e workshop-it	5
2.2. Prezantimi i dymbëdhjetë partneriteteve pjesëmarrëse komunale.....	7
2.3. Fjalim: Axhenda 2030 me objektivat e saj globale dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe integrimi i tyre në strukturat komunale	10
2.4. Punë në grup „Beyond Cherry Picking“. Axhenda 2030: Çfarë do të thotë kjo gjë për komunën time?	11
2.5. Fjalim: Pasqyrë mbi projektin „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“	12
2.6. Fjalim: Qëndrueshmëria në Gelsenkirchen	13
2.7. Vizita në shtëpinë Hans-Sachs.....	14
2.8. Pritja në mbrëmje dhe dorëzimi i <i>Memoranda of Understanding</i> në shtëpunë Hans-Sachs.....	14
3. Workshop-i i parë – Dita e 2-të	15
3.1. Informacion për grupin: Mënyra e qasjes në projektin „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“	15
3.2. Fjalim: Ecuria organizative e fazës pilot.....	17
3.3. Punët në grup:	19
3.4. Lamtumira.....	22
Shtojca	23
Programi	23
Lista e pjesëmarrësve.....	25

1. HYRJE

4

Me workshopin e parë zyrtar, në të cilin morën pjesë dymbëdhjetë partneritete të qëndrueshme ndërmjet komunave gjermane dhe komunave nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia, projekti "Partneritetet e Qëndrueshme Komunale" ka startuar me sukses në fazën e tij pilot. Projekti zbatohet nga qendra e shërbimeve Komunitat në Njërin Botë (SKEW) nga Engagement Global me porosi të Ministrisë Federale për Bashkëpunim ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).



Informacioni dhe regjistrimi i pjesëmarrësve në vendin e organizimit të eventit

Në eventin e parë dy-ditor me 16 dhe 17 Janar 2017 në Hans-Sachs-Haus në Gelsenkirchen, SKEW përshëndeti rreth 100 përfaqësues dhe përfaqësues komunalë nga Gjermania dhe Evropa Jug-Lindore si dhe aktorë të tjerë nga sektorët e partneriteteve të qyteteve dhe të qëndrueshmërisë. Për fazën dy-vjeçare të projektit komunitat partnerë ranë dakord për një bashkëpunim sistematik në sektorin e Axhendës 2030 dhe 17 objektivat e saj globale (*Sustainable Development Goals*, SDGs). SKEW ju shoqëron, këshillon dhe mbështet juve në këtë proces.

Pasqyra e partneriteteve të qëndrueshme ndërmjet komunave gjermane dhe nga Evropa jug-lindore (Versioni Janar 2017)

Gjermani	Bosnja dhe Hercegovina
Gelsenkirchen	Zenica
Gera	Goražde
Langenhagen	Bijeljina
Lajpcig	Travnik
Wolfsburg	Sarajevë
Gjermani	Kosovë
Kirchhain	Smirë, Komuna Viti
Troisdorf	Mushtisht, Komuna Suharekë
Gjermani	Serbi
Qarku Treptow-Köpenick nga Berlioni dhe kryeqyteti i landit Mynih	Subotica
Ingolstadt	Kragujevac
Offenbach am Main	Zemun (lagje me administrim të pavarur e Beogradit)
Pfaffenhofen an der Ilm	Valjevo
Komuna e bashkuar Bersenbrück	Ruma

2. WORKSHOP-I I PARË – DITA E 1-RË

2.1. Hapja e workshop-it

Martina Rudowitz, Kryetarja e Bashkisë e Gelsenkirchen



Kryetarja e Bashkisë e Gelsenkirchen Martina Rudowitz hap eventin

Kryetarja e Bashkisë Martina Rudowitz hapi eventit dhe i uroi mirëseardhjen të ftuarve në shtëpinë Hans-Sachs në emër të qytetit të saj. Ajo përshëndeti faktin që komunat e pranishme dëshirojnë të vazhdojnë të hapen ekonomikisht, ekologjikisht dhe në aspektin social si dhe ndërkombëtarisht në kuadrin e qëndrueshmërisë. „Për këtë gjë“, tha Martina Rudowitz, „unë ju uroj suksese dhe forcë.“ Axhenda 2030 është një kornizë e rëndësishme për projektin pasi ajo premtan si përmirësime të kushteve të jetës për të gjithë njerëzit ashtu edhe për mjedisin e tyre – dy objektiva të rëndësishme përballë sfidave të mëdha globale.

Ulrich Kaltenbach, BMZ



Ulrich Kaltenbach përshëndet pjesëmarrësit në emër të Ministrisë Federale për Bashkëpunim ekonomik dhe Zhvillim

Ulrich Kaltenbach, specialist në Ministrinë Federale të Bashkëpunimit ekonomik dhe të Zhvillimit (BMZ), përshëndet të ftuarit edhe në emër të ministrit federal të zhvillimit Dr. Gerd Müller. „Komunat në të gjithë botën gjenden para sfidave gjigante. Urbanizimi që shtohet, varfëria, rritja e numrit të refugjatëve, transformimi klimaterik, shërbimi shëndetësor dhe mobiliteti janë disa nga ato. Në disa qytete, tashmë disa koka të zgjuara po përpunojnë zgjidhje praktike për këto sfida. Prandaj komunat janë shumë të rëndësishme. Ato posedojnë dijet për të gjetur zgjidhje për problemet globale në vend.“

Ulrich Kaltenbach nënvizoi rëndësinë e madhe politike, që BMZ i jep projektit që zbatohet nga SKEW. Ai përshëndeti veçanërisht faktin që u arrit që të ftohen komunat partnere nga Evropa Jug-Linfore për fazën pilot: "Është kënaqësi për ne të zhvillojmë me ju një dialog në të njëjtin nivel dhe të gjejmë rrugë të përbashkëta për ta organizuar drejtë dhe në mënyrë të qëndrueshme globalizimin."

Jessica Baier, SKEW

Në emër të SKEW të ftuarit i përshëndeti Jessica Baier, sidomos aktorët e 25 komunave të përfaqësuara

„25 komuna janë mbledhur sot këtu për fillimin e këtij projekti të përbashkët. Kjo është një gjë tepër e veçantë”, deklaroi Jessica Baier, e cila i përshëndeti të ftuarit në emër të SKEW dhe i prezantoi me emër të gjitha komunat e përfaqësuara. Që më parë, të pranishmit ishin familjarizuar në dy workshop-e me Axhendën 2030 dhe rëndësinë e saj për punën e partneritetit. Gjithsej kishte rreth 20 kërkesa nga të interesuarit për të marrë pjesë në fazën pilot të SKEW. U zgjodhën dymbëdhjetë partneritete (ndër të cilat një partneritet tre-këndor), të cilat do të marrin pjesë në dy vitet e ardhshme në fazën pilot.

Duke marrë për bazë përvojat ekzistuese të komunave në sektorin e qëndrueshmërisë, tani bëhet fjalë për etablimin e një dialogu për objektivat e Axhendës 2030 si dhe për aktivitetet e përbashkëta për arritjen e këtyre objektivave. Jessica Baier nënvizoi aktualitetin e temës dhe trajtoi rëndësinë e saj të veçantë për partneritetet komunale. Ajo i uroi të gjithë pjesëmarrësve suksese dhe i falënderoi qytetin pritës Gelsenkirchen, i cili merret tashmë prej një kohe të gjatë dhe në mënyrë intensive me aspektet e qëndrueshmërisë.

2.2. Prezantimi i dymbëdhjetë partneriteteve pjesëmarrëse komunale

Në grupe të vogla, moderatori Patrick Leusch ju lute të gjithë përfaqësuesve dhe përfaqësuesve komunale të vinin në podium, për të prezantuar shkurtimisht partneritetin e tyre përkatës.

Tabela 2 : Profile të shkurtra të partneriteteve pjesëmarrëse

Partneriteti	Numri i banorëve	Madhësia e sipërfaqes	Viti i themelimit të partneritetit	Aktivitetet e deritanishme
Gelsenkirchen	257.607	104,8 km ²	1969	Partneriteti ndërmjet Gelsenkirchen dhe Zenica është më i vjetri në projekt. Dhe për këtë arsye e madhe është edhe larmia e tematikave, të cilat të dy qytete kanë përpunuar së bashku me kalimin e viteve. Aktualisht gjendet në plan të parë trajtimi i sipërfaqeve të mëparshme të industrisë së rëndë. Gelsenkirchen ka grumbulluar këtu në kuadrin e transformimit strukturor në Ruhrgebiet përvoja të dobishme.
Gera	95.969	151,9 km ²	2002	Prej 20 vitesh Gera dhe Goražde bashkëpunojnë në partneritet dhe vazhdimisht në shumë çështje shoqërore, për të arritur objektiva lokale dhe globale. Shumë projekte të përbashkëta, ndër të tjera në sektorin e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara, kanë përfunduar tashmë. Njëpër një projekt pilot „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“, partneriteti merr edhe një herë një shtysë të re.
Goražde, Bosnja dhe Hercegovina	22.080	252 km ²		
Langenhagen	51.691	71,99 km ²	2007	Prej vitesh ekziston ndërmjet Langenhagen dhe Bijeljina një bashkëpunim i mirë civilo-shoqëror në sektorët e kulturës dhe emigracionit. Tani më ekziston edhe një kontakt komunal shumë i mirë dhe miqësor.
Bijeljina, Bosnja dhe Hercegovina	114.663	734 km ²		
Lajpcig	520.838	297,6 km ²	1995	Si partneritet tepër aktiv me tema të larmishme dhe përballje të shumta ndër-njerëzore u prezantuan Lajpcigu dhe Travnik. Për partneritetin e tyre vital të dyja komunave i janë akorduar tashmë çmime nga Bashkimi Evropian (BE). Në të dyja qytetet ekzistojnë zyra dhe shoqata partneriteti. .
Travnik, Bosnja dhe Hercegovina	57543	529 km ²		

Partneriteti	Numri i banorëve	Madhësia e sipërfaqes	Viti i themelimit të partneritetit	Aktivitetet e deritanishme
Wolfsburg	125.500	204 km ²	1985	Partneriteti i qyteteve ndërmjet Wolfsburg dhe Sarajevës ekziston tashmë prej 30 vitesh. Përveç sektorëve të ekonomisë dhe shkencës në fokusin e bashkëpunimit janë edhe sporti dhe kultura. Tani të dyja qytetet presin me kënaqësi bashkëpunimin për Axhendën 2030.
Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina	291.422	141,5 km ²		
Qarku Treptow-Köpenick i Berlinit	257.782	168,42 km ²	Subotica - Mynih: 2000	Me dy komuna gjermane dhe një serbe ky partneritet është bashkimi i vetëm tresh në projektin pilot „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“:
Mynih	1.500.000	310,7 km ²	Subotica - Treptow-Köpenick: 2002	Në sektorët e sportit, kulturës dhe shkëmbimit ndërmjet të rinjve ekziston tashmë një kontakt intensiv. Do të shtohen edhe arsimi dhe çështjet sociale.
Subotica, Serbi	105.681	290 km ²		Të tre palët dëshirojnë të mësojnë nga njëri-tjetri, megjithëse koordinimi i partneritetit tresh paraqet një sfida.
Kirchhain	17.557	90,92 km ²	2016	Bazuar në zhvillimin e tyre (të qëndrueshëm), komunat më të vogla si ajo e Viti-t në Kosovë gjenden ende përballë sfidave të mëdha. Bashkëpunimi ndërmjet Viti-t dhe Kirchhain fillon vetëm tani. Të dyja palët shpresojnë për një proces të përbashkët të mësuarit dhe një bashkëpunim të mirë në sektorët e energjive të rinovueshme dhe të bujqësisë së qëndrueshme.
Smirë, Komuna Viti, Kosovë	46.987	267 km ²		
Troisdorf	75.369	62,17 km ²	2001	Suharekë dhe Troisdorf bashkëpunojnë prej 2001 në shumë sektorë, për shembull në furnizimin me ujë, në ekonomi dhe në turizëm. Komunat presin me kënaqësi të fillojnë së bashku punën për Axhendën 2030 dhe të bëjnë me dije në mënyrë të ndërgjegjshme temat dhe objektivat e axhendës në të dyja komunat.
Mushtisht, Komuna Suharekë	59.702	387 km ²		
Ingolstadt	132.438	133,4 km ²	2003	Zyrtarisht ky partneritet ekziston prej 2003, por edhe më parë ka pasur shumë kontakte ndërmjet Ingolstadt dhe Kragujevac. Të gjitha projektet janë kryer tashmë të gjitha së bashku, ndër të tjera në sektorët e shkëmbimeve ndërmjet nxënësve dhe kulturës. Njëpërmyjet projektit „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“ duhet të forcohet më tej bashkëpunimi intensiv.
Kragujevac, Serbi	179.417	835 km ²		

Partneriteti	Numri i banorëve	Madhësia e sipërfaqes	Viti i themelimit të partneritetit	Aktivitetet e deritanishme
Offenbach am Main	116.945	44,9 km ²	(1956) 1999	Në 1956 Offenbach dhe Zemun janë bashkuar bashkë me komuna të tjera evropiane në një „Unazë partneriteti“. Në momentin që Zemun u përfshi në bashkësimin e qytetit të Beogradit, komuna u shpëtoi nga „Unaza e partneritetit“. Offenbach dhe Zemun ka rimmarrë përsëri kontaktin e partneritetit në 1999. Njëpërmjet pjesëmarrjes në projektin „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“ duhet që të ri-gjallërohet dhe të thellohet profesionalisht bashkëpunimi.
Pfaffenhofen an der Ilm	23.971	92,39 km ²	1999	Bashkëpunimi prej 1999 qytetet kanë bashkëpunuar shumë mirë së bashku. Me pjesëmarrjen në projektin pilot „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“ tani ka filluar një fazë e re e partneritetit ndërmjet Pfaffenhofen an der Ilm dhe Valjevo. Themeli i shkëmbimit ishin si fillim bashkëpunimet në sektorin e artit dhe kulturës. Në të ardhmen duan që ti përkushtohen së bashku menaxhimit të qëndrueshëm të sipërfaqeve të gjelbra të qytetit.
Komuna e bashkuar Bersenbrück	7.961	42,54 km ²	2016	Deri më tani nuk ekziston një partneritet zyrtar ndër-qytetas, por të dyja palët shpresojnë që brenda 2017 të mund të nënshkruhet një kontratë.
Ruma, Serbi	30.656	582 km ²		Shoqata „Të ndërtojmë ura“ ka mbështetur shumë në dy vitet e fundit një partneritet ndërmjet komunës së përgjithshme Bersenbrück dhe Ruma. Edhe tani ekzistojnë shumë kontakte, për shembull njëpërmjet shkëmbimit të të rinjve.

Pas partneriteteve komunale u prezantuan edhe përfaqësueset dhe përfaqësueset të Pas partneriteteve komunale u prezantuan edhe përfaqësueset dhe përfaqësuesit pjesëmarrës të shoqatave komunale nga Gjermania, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia. Ato përshëndetën projektin ndërkombëtar dhe i prematuan qyteteve mbështetjen e tyre. . Ato përshëndetën projektin ndërkombëtar dhe i prematuan qyteteve mbështetjen e tyre.



Pjesëmarrësit serb dhe gjerman gjatë prezantimit të partneriteteve komunale

2.3. Fjalim: Axhenda 2030 me objektivat e saj globale dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe integrimi i tyre në strukturat komunale

Dr. Eva Dick, Instituti Gjerman për Politikë Zhvillimi



Dr. Eva Dick nga Instituti Gjerman për Politikë Zhvillimi në fjalimin e saj për Axhendën 2030 dhe rolin e Komunave

Specialistja bëri një prezantim për Axhendën 2030 dhe u fokusua sidomos në rëndësinë e madhe në të gjithë botën të qyteteve dhe komunave për arritjen e 17 objektivave të qëndrueshmërisë (*Sustainable Development Goals*, SDGs). Në 2015 u miratua „Axhenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm“ nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si pasuese e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (*Millennium Development Goals*, MDGs) – . Por SDGs janë më shumë se vetëm vazhdimi i përshkrimit të MDGs. SDGs janë nga përmbajtja me ndikim më të gjerë se objektivat e mëparshëm. Për herë të parë objektivat e zhvillimit dhe të qëndrueshmërisë merren parasysh në të njëjtën masë në varësitë e tyre të larmishme. Një ndryshim tjetër thelbësor

kundrejt MDGs qëndron në faktin që objektivat e Axhendës 2030 ngrenë një pretendim universal – pra që vlen në të njëjtën masë për të gjitha vendet – dhe e detyrojnë bashkësinë botërore si të tërë.

Roli rëndësishëm i komunave ndër të tjera përmendet në mënyrë eksplicite në SDG 11 („Qytete dhe Komuna të Qëndrueshme“) si dhe në SDG 17 („Partneritete, për të arritur objektivat“). Lokalizimi i SDGs, pra përkthimi në kontekstin lokal dhe përvetësimi i tyre në vend është një faktor i rëndësishëm për implementimin e Axhendës 2030. Studimet shkencore kanë treguar: Gjatë implementimit të 45 përqind të objektivave dhe nën-objektivave të Axhendës 2030, qytetet dhe komunat luajnë një rol qendror.

Por në të njëjtën kohë objektivat e qëndrueshëm janë të dobishme edhe për komunat. Ato japin orientime dhe arsye konkrete për të përshtatur plane ekzistuese vendore zhvillimi. Për këtë gjë ato mundësojnë akses për te resurse të agjencive ndërkombëtare dhe kombëtare. Të mësuarit dhe rrjetet ndër-komunale forcohen në lokalizimin e tyre nga Axhenda 2030.

Diskutimi mbi fjalimin

Pyetje: "Si mund të zgjidhet problemi që shumë pak qytetarë interesohen për temën Axhenda 2030, pasi duket sikur ka shumë pak lidhje me jetën e përditshme?"

Dr. Eva Dick: „Faktikisht është një gjë e tillë në shumë vende është një sfidë. Por ekzistojnë shumë shembuj të mirë për një komunikim të arritur ndërmjet institucioneve komunale dhe qytetarëve. Ekzistojnë edhe shembuj të mirë për kultura politike në të cilat pjesëmarrja e qytetarëve funksionon. Kjo konferencë ofron një kornizë të përshtatshme për të shkëmbyer informacione edhe mbi temën e pjesëmarrjes.“

Pyetje: "Nuk është më mirë që të mund të tregosh në fillim rezultate të shpejta, të matshme për të bindur njerëzit?"

Dr. Eva Dick: "Kjo është shumë e rëndësishme. Por përtej hapave dhe masave të veçantë është e nevojshme të mendohesh mirë se: Cilët institucione dhe aktorë janë të rëndësishëm për procesin? Edhe rezultatet e vogla të 'kapshme' mund të futen në një plan të integruar"




Fig. 1: Misselwitz, P., Salcedo Villanueva, J.: 2016: Dimensionet urbane të SDGs: Implikimet për Axhendën e re urbane, S. 7

Për më tepër, në diskutim, shumë pjesëmarrës ishin pro idesë, për ta sjellë më shumë në plan të parë temën e Axhendës 2030 në arsimimin e të rriturve dhe në komunikim. Në rastin e temës së qëndrueshmërisë kemi të bëjmë më shumë se "vetëm" me mbrojtjen e mjedisit.

2.4. Punë në grup „Beyond Cherry Picking“. Axhenda 2030: Çfarë do të thotë kjo gjë për komunën time?

Pjesëmarrësit thellojnë pikat e tematizuara në fjalim në grupe të vogla të ndara sipas gjuhës. Me mbishkrimin „Beyond Cherry Picking“ kishim të bënim me faktin për ti hedhur një shikim varësive ndërmjet 17 objektivave. Mos zgjedhje vetëm e qershive, pra mos-ndjekja vetëm e temës së preferuar, por shkëmbimi i ide mbi ndikimet e ndërsjellta ndërmjet sektorëve të veçantë të Axhendës 2030 në nivelin komunal, ishte qëllimi i kësaj njësie pune. Ku ekzistojnë varësi të qarta ndërmjet SDGs të veçanta? Ku bien më pak në sy lidhjet? Çfarë ndikimesh ka një gjë e tillë mbi komunën time? Për cilat objektiva kemi punuar

ne tashmë? Dhe cilat tema të papunuara deri tani mund të na zhvillojnë më tej neve si komunë?



Pjesëmarrësit nga Kosova gjatë punës në grup

Çdo grup pune zgjodhi një poster si model pune, në të cilin në fokus ishte një SDG, i cili ishte rrethuar në formë rrethi nga shumë SDG. Pjesëmarrësit, nga perspektiva e tyre përkatëse komunale krijojnë lidhje ndërmjet objektivave të veçanta të qëndrueshme.

Prezantimi i rezultateve të punës

Gjithsej u formuan tetë grupe pune (AGs). Çdo grup mund të zgjidhte një model nga tre modelet e punës.¹

AG zgjodhën modelet të cilat në qendër të vëmendjes ishin SDGs 1 („Jo varfërisë“), 4 („Arsim me cilësi të lartë“), 8 („Punë humane dhe rritje ekonomike“), 9 („Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë“), 11 („Qytete dhe Komuna të qëndrueshme“) dhe 12 („Konsum dhe prodhim i qëndrueshëm“). Ndërkohë që pjesëmarrësit e Evropës Jug-lindore vendosën për SDGs 1, 4, 8, 11 dhe 12, dhe pjesëmarrësit gjerman për SDGs 9, 11 dhe 12. Sidomos për objektivat e qëndrueshme 1, 11 dhe 12 u treguan shumë varësi me SDGs e tjera. Kështu SDG 9 u lidh fort me SDGs 11 dhe 12 – si për në modelin e punës, tek e cila SDG 9 ishte në fokusin kryesor ashtu edhe tek modelet të cilat kishin në fokusin kryesor SDG 11 ose SDG 12.

Përfaqësueset dhe përfaqësuesit komunal nga Gjermania konsiderojnë si urgjente mbi të gjitha aspektet e qëndrueshmërisë, mjedisit dhe ekologjisë. Ndërkohë që aktorët komunal nga komunat e Evropës jug-lindore e vendosin fokusin e tyre sidomos në aspektet që lidhen me zhvillimin si rritja ekonomike, arsimi dhe varfëria. Përgjithësisht kjo gjë pasqyron karakterin transformues të Axfordës 2030, duke qenë se këtu ndërthuret principi i qëndrueshmërisë për herë të parë me zhvillimin ekonomik, ekologjik dhe social dhe axhenda - ndryshe nga sistemet e mëparshme kombëtare të zhvillimit - vlen njëloj për të gjitha vendet e botës.

2.5. Fjalim: Pasqyrë mbi projektin „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“

Jessica Baier dhe Isabela Santos, SKEW

Jessica Baier dhe Isabela Santos shpjeguan se çfarë shansesh ofron Axhenda 2030 për politikën komunale të zhvillimit dhe si mund ti mbështesë SKEW komunat në kuadrin e projektit „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“.

"Partneritetet e Qëndrueshme Komunale" i shërbejnë realizimit të ambicieve të përbashkëta mbi objektivat e qëndrueshme të zhvillimit, SDDs në "nivele lokal", tha Jessica Baier. Në fazën pilot me partneritetet ekzistuese ndërmjet komunave nga Gjermania dhe Evropa Jug-Lindore tani bëhet fjalë vetëm për përfundimin e partneriteteve duke shkëmbyer eksperiencën, bashkëpunimin, transferimin e dijeve dhe mbështetjen e fokusuar. Ju mund të përballeni së bashku me sfidat që dalin nga zhvillimi i qëndrueshëm. "Ne dëshirojmë ti inkurajojmë komunat të veprojnë lokalisht dhe ndikojnë globalisht".

Isabela Santos prezantoi ecurinë e procesit për dy vjetët e ardhshme dhe theksoi: "Në fokus qëndron shkëmbimi në të njëjtin nivel". SKEW e mbështet këtë proces nëpërmjet financimit të delegacioneve, takimeve të rrjeteve, eventeve të para dhe përmbyllëse si dhe nëpërmjet nxitjes financiare të një eventi me ndikim në publik dhe të një mase pilot në vend. Në vazhdimësi, komunat për më tepër këshillohen profesionalisht dhe metodologjikisht nga SKEW. Isabela Santos: "Faleminderit që jeni të gjithë këtu sot. Ky bashkëpunim është kënaqësi e madhe për mua".

1 Puna në grup bazohej në Tool „A Nexus Approach for the SDGs - Interlinkages between the goals and targets“, me të cilën lidhja ndërmjet SDGs mund të vizualizohej dhe të tregohej qartë. Modeli mund të shkarkohet në faqen e uebit të Kombeve të Bashkuara nën: <https://www.un.org/ecosoc/sites/www.un.org.ecosoc/files/files/en/2016doc/interlinkages-sdgs.pdf>.




Fig. 2: Ecuria e fazës pilot të projektit „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“

2.6. Fjalim: Qëndrueshmëria në Gelsenkirchen

Werner Rybarski, Drejtor Administrate në Axhenda 21 të qytetit Gelsenkirchen, ka një eksperiencë të gjatë me temën e qëndrueshmërisë. Në vitin 1997 këshilli i qytetit Gelsenkirchen vendosi unanimisht për ndërtimi e Axhendës Lolake 21. Personi përgjegjës për Axhendën 21 Werner Rybarski prezantoi disa gurë kilometrik të zhvillimit lokal të qëndrueshëm të qytetit të tij. „Kushtet janë të ndryshme në çdo komunë. Por unë shpresoj t’ju jap juve disa nxitje“.

Bazuar në moton "Nga projekti te principi" u arrit me kalimin e viteve në Gelsenkirchen, që të përfshihen gjithmonë dhe më shumë grupe të popullsisë në proceset e qëndrueshmërisë. Nëse në fillimi ishin rrethe pune të cilët merreshin me

implementimin e projekteve të vogla të dobishme, me rritjen e përvojës dhe të profesionalizmit projektet u bënë gjithmonë dhe më të mëdha, ndër to për shembull "ÖKOPROFIT", një projekt me ekonominë vendore për teknologji të integruar të mjedisit duke marrë shembullin zviceran.

Mbi 100 në sektorin e qëndrueshmërisë u arritën të implementohen deri më tani. Nga kjo gjë u zhvillua një rrjet i madhe dhe struktura fikse për më shumë qëndrueshmëri lokale. Si shembull përmendi Werner Rybarski „Kolleg 21“ me të rinj nga Gelsenkirchen, që përfshin drejtpërsëdrejti të rinjtë si dhe sektorin unik të programit të shkollave të mesme „Qëndrueshmëria“ në të gjithë federatën. Qartësimi i masave për rinovimin e qëndrueshëm të qytetit, për trajtimin e sipërfaqeve të vjetra industriale, për mbrojtjen klimaterike




Fig. 3: Tema the pika ndërthurje të procesit të Axhendës 21 në Gelsenkirchen (Marrë nga : Zyra e Axhendës 21 Gelsenkirchen)

dhe për arsimin për një zhvillim të qëndrueshëm: Tema e qëndrueshmërisë ka mbërritur në kokat e shumë grave dhe burrave nga Gelsenkirchen. Që në 2015 ka patur një vendim unanimit të këshillit për implementimin e Axhendës 2030 në nivelin komunal.



Pjesëmarrësit nga Kosova gjatë vizitës në shtëpinë Hans-Sachs

2.7. Vizita në shtëpinë Hans-Sachs

Në përfundim të fjalimit të tij Werner Rybarski ftoi të pranishmit të merrnin pjesë në një vizitë në shtëpinë Hans-Sachs, në vendin ku zhvillohet eventit dhe pikë referimi e qytetit. Ndërtimi u bë në stilin e Funkcionalizmit nga viti 1925 deri në 1927 dhe u shemb plotësisht në 2012, u riparua plotësisht dhe u rinovua në mënyrë të qëndrueshme. Shtëpia Hans-Sachs me cepat e saj karakteristik të rrumbullakët në fasadën me tulla ka qenë gjithmonë më shumë se bashkia: Këtu janë zhvilluar evente kulturore, festa dhe organizime të tjera. Megjithëse e mbrojtur si monument kultura, shtëpia e vjetruar duhej të shembej por qytetaret dhe qytetarët e qytetit luftuan për ruajtjen e saj. E ri-konstruktuar në mënyrë të qëndrueshme ajo u hap përsëri në 2013 dhe vendos tani standarde të reja me anën e arkitekturës së saj të brendshme transparente, moderne, furnizimin e saj me energji nëpërmjet një sistemi gjeo-termik si dhe me anën e impiantit foto-voltaik mbi çati dhe përdorimin e ujit të shiut për tualetin. Soot zhvillohen këtu përsëri evente kulturore dhe evente të tjera në këtë shtëpi. Një ekzpozitë e përhershme jep për më tepër një retrospektivë në historinë e qytetit Gelsenkirchen.

2.8. Pritja në mbrëmje dhe dorëzimi i Memoranda of Understanding në shtëpinë Hans-Sachs



Dr. Stefan Wilhelmy, Drejtor i SKEW, i uroi pjesëmarrësve mirëseardhjen në pritjen e mbrëmjes

Në një atmosferë festive u zhvillua në mbrëmje dorëzimi i Memoranda of Understanding (MoU) ndërmjet komunave pjesëmarrëse dhe SKEW. Përveç kryetares së bashkisë së Gelsenkirchen Martina Rudowitz mirëseardhjen ja uroi të pranishmëve edhe Dr. Stefan Wilhelmy, Drejtor i SKEW, si dhe Heinz Meyer nga Rrethi i Iniciativës Zenica. Pas nënshkrimit të MoUs të pranishmit e përfunduan ditën duke ngrënë darkë bashkë dhe duke dëgjuar muzikë.



Dr. Stefan Wilhelmy, Drejtor i SKEW, dhe përfaqësuesit dhe përfaqësueset e partneritetit komunal të të gjithë komunës Bersenbrück dhe Ruma/Serbi nënshkruan Memorandum of Understanding

3. WORKSHOP-I I PARË – DITA E 2-TË

Pas një përmbledhje të temave të trajtuara ditën e parë, moderatori Patrick Leusch e drejtoi shikimin para: "Tema e sotshme është që të konkretizojmë gjërat, të biem dakord për hapat e parë të përbashkët dhe të punojmë për plane dhe detyra konkrete, për të filluar bashkëpunimin në kuadrin e projektit "Partneritetet e Qëndrueshme Komunale".

3.1. Informacion për grupin: Mënyra e qasjes në projektin „Partneritetet e Qëndrueshme Komunale“

Komunat partnere kishin rënë dakord para workshop-it në lidhje me një nga mënyrat e mundshme të qasjes. Shumica vendosën për variantin „Proces i përbashkët aksioni për të mësuar – *learning by doing*“. Ndërkohë partnerët Lajpcig dhe Travnik zgjodhën opsionin „Së bashku në rrugën e strategjisë së qëndrueshme“. Për të mënyrat e qasjes nga ana e SKEW ofrohen të njëjtat shërbime.

Mënyra e qasjes I: „Së bashku në rrugën e strategjisë së qëndrueshmërisë“

Jessica Baier, SKEW

Në këtë mënyrë qasje partnerët punojnë në një proces dialogu me shumë aktorë një kuptim të përbashkët për Axhendën 2030 dhe për SDGs. Ato këshillohen së bashku për zhvillimin ose përpunimin e strategjive ekzistuese të qëndrueshmërisë dhe identifikojnë aktivitete në të dyja komunat, të cilat mund të implementohen së bashku në kuadrin e punës së partneritetit komunal. Qëllimi është krijimi i një plan-veprimi/program-veprimi të përbashkët për implementimin e Axhendës 2030. Implementimi i një mase pilot si pjesë e programit të veprimit është parashikuar në fund të procesit të përbashkët të punës në kuadrin e fazës pilot të të gjithë projektit.

Këtë rrugë zgjodhën Lajpcigu dhe Travnik. Të dy qytetet duan të startojnë një shkëmbim intensiv mbi strategjitë ekzistuese të qëndrueshmërisë, të këshillohen reciprokisht dhe bazuar në to të zhvillojnë strategji të reja. Të dyja komunat po përpunojnë aktualisht strategjitë e tyre ekzistuese: Lajpcigu punon për krijimin e një „Koncepti të integruar të zhvillimit të qytetit“, që do të miratohet në 2018 si „Lajpcig 2030“, dhe Travnik për një „Strategji zhvillimi“ për periudhën kohore 2020 deri 2030. Pra momenti kohor është i



Fig. 4: Ecuria e fazës pilot të „Partneriteteve Komunale të Qëndrueshme“ (Mënyra e qasjes I)

përshtatshëm për të filluar një proces reciprok këshillimi.

Mënyra e qasjes II: „Procesi i përbashkët i aksionit të të mësuarit – learning by doing“

Isabela Santos, SKEW

Në rastin e kësaj qasje partnerët bien dakord për një ose disa SDGs, të cilat do të përpunohen në kuadrin e SDG 11 („Qytete dhe Komuna të Qëndrueshme“) dhe SDG 17 („Partneritete për të arritur objektivat“). Për këtë gjë zhvillohet dhe zbatohet së bashku për të dyja komunat përkatësisht një masë pilot. *Learning by doing* është në plan të parë në këtë proces-aksion të mësuarit. Nëpërmjet kryerjes së një mase pilot synohet që implementimi i Axfenda 2030 të bëhet i prekshëm në mënyrë konkrete për aktorët si dhe qytetaret dhe qytetarët. Përvojat me implementimin e një mase pilot vlerësohen në fund dhe përdoren për planifikimin strategjik të bashkëpunimit të mëtejshëm në kuadrin e partneritetit të qëndrueshëm. Një publik i gjerë duhet të kontaktohet dhe të përfshihet gjatë gjithë procesit.

Masat pilot – Këshilla dhe shembuj të praktikës së mirë

Për t’ju përgjigjur siç duhet kompleksitetit dhe objektivave të Axfendës 2030, duhet që gjatë zhvillimit të masës pilot të respektohen disa kritere të caktuara. Isabela Santos dhe Jessica

Baier e shpjegojnë një gjë të tillë me anën e disa shembujve nga praktika komunale.

Masat pilot duhen implementuar në një periudhë kohore prej pak muajsh dhe nuk duhet të kalojnë volumnin financiar prej 5.000 Eurosh. Për më tepër duhet që gjatë planifikimit të merren parasysh aspektet e mëposhtme të rangut më të lartë:

- Duhet të jenë të përfshirë si aktorë nga politika dhe administrata komunale ashtu edhe nga shoqëria civile në planifikim dhe në implementim. Duhet të jenë të përfshira të paktën dy zyra profesionale të administratës komunale për të nxitur një bashkëpunim që përfshin të gjitha resurset.
- Masa duhet ti referohet të paktën dy SDSs. Gjatë kësaj duhet që ti kushtohet vëmendje sidomos edhe ndërthurjes ndërmjet SDGs të veçanta. Të dyja komunat e një partneriteti duhet ti referohen përkatësisht të njëjtave SDGs, ndërkohë që procesimi konkret i të dyja masave pilot mund të ndryshojë në kuadrin e SDGs të përzgjedhura dhe duhet orientuar në nevojat konkrete të komunave të veçanta.
- Masa duhet të tregojë një karakter transformues, që do të thotë që të kenë si objektiv transformimin e një mënyrë qasje të qëndrueshme në drejtimin e një mënyrë qasje më shumë të qëndrueshme.
- Masa duhet të zgjerojë spektrin e aktiviteteve lokale të komunës dhe duhet të mundësojë të mësuarin ndër-komunal në kuadrin e partneritetit.



Fig. 5: Ecuria e fazës pilot të „Partneriteteve Komunale të Qëndrueshme“ (Mënyra e qasjes II)

SKEW i prezantoi pjesëmarrësve **Shembuj nga praktika e mirë**, të cilat mund të kuptohen si nxitje për planifikimi e një mase vetjake pilot:

- Në Freiburg aktorët iniciuan një projekt për të reduktuar ndotjen në rritje të mjedisit me anën e **gotave një-përdorimëshe të kafesë (coffee to go)**. Ato zhvilluan për këtë gjë një sistem me pagesë për gotat dhe ia bënë me dije shitësve dhe klientëve atje në vend. Ky projekt ka lidhje me SDG 12: („Prodhim i qëndrueshëm dhe konsum i qëndrueshëm“) dhe SDG 14 („Jeta nën ujë“). Sidomos në tre nën-objektivat e mëposhtme projekti ka ndikime pozitive:²
 - Nën-objektivi 12.5: „Deri në 2030 të ulet qartë gjenerimi i mbetjeve duke mënjanuar, zvogëluar, ricikluar dhe ripërdorur“
 - Nën-objektivi 12.3: „Deri në 2030 të përgjysmohet keqpërdorimi i ushqimeve për kokë në nivelin e tregtisë me pakicë dhe të konsumatorit [...]“
 - Nën-objektivi 14.1: „Deri në 2025 të zvogëlohen qartë të gjitha llojet e ndotjes së deteve nga aktivitetet që këshillohen në breg dhe duke përfshirë mbetjet detare [...]“
- Masa të tjera në këtë sektor mund të jenë shpërndarja e trastave prej lecke në tregun lokal (shembull nga Unterschleißheim) ose përgatitja e një udhëheqësi për kryerjen e blerjeve si në Würzburg („bio, rajoonal, fair“).
- Komuna Glonn përcaktuar një „Energie-Lehrpfad Markt Glonn“, për të rritur ndërgjegjësimin për energjitë e rinovueshme dhe për të rritur për shembull rëndësinë e kënetave si magazinues i CO2. Boshti mësimor i energjisë kontribuon për arritjen e objektivave dhe nën-objektivave të ndryshme:
 - SDG 7: „Energjia e rinovueshme“
 - Nën-Objektiva 7.1: „Deri në 2030 të sigurohet akses i përgjithshëm te shërbime të pagueshme, të sigurte dhe moderne të energjisë“
 - Nën-objektivi 7.2: „Deri në 2030 të rritet shumë pjesa e energjisë së rinovueshme në miksin global të energjisë“ Përveç kësaj bëhen lidhjet me SDGs 13 („Masat për mbrojtjen e klimës“) dhe 15 („Jeta në fshat“) me nën-objektivat e mëposhtme:

2 „Dokumentin final të samitit të Kombeve të Bashkuara për miratimin e Axfordës së Zhvillimit Post-2015“ me objektivat dhe nën-objektivat e Axfordës 2030 e gjeni në faqen e uebit të Kombeve të Bashkuara në: <http://www.un.org/depts/german/gv-70/a70-l1.pdf>. Të gjitha nën-objektivat e paraqitura më poshtë janë marrë fjalë për fjalë nga ky dokument.

Nën-objektivi 13.3: „Përmirësimi i informimit dhe sensibilizimit [...] në sektorin e dobësimit të transformimit klimaterik [...]“

Nën-objektivi 15.3: „Deri në 2030 të luftohet formimi i shkretëtirave [...] dhe të synohet një botë në të cilën të neutralizohet tharja e vendeve“

- Në Bottrop u krijua një **„Kopsht i përbashkët“**, në menaxhimin e të cilit përfshihen fokus-grupe të ndryshme, ndër të cilat edhe emigrante dhe emigrantë me aftësi të kufizuara. Edhe ky plan-projekt kontribuon në implementimin e SDGs të ndryshme. SDG 13 („Masat për mbrojtjen e klimës“) merret parasysh në këtë projekt nëpërmjet:
 - Nën-objektivi 13.2: „Përfshirja e masave për mbrojtjen e klimës në politikat, strategjitë dhe planifikimet kombëtare“
 - Nën-objektivi 13.3: „Përmirësimi i informimit dhe sensibilizimit [...] në sektorin e dobësimit të transformimit klimaterik [...]“
- Për më tepër krijohen lidhje me SDGs 10 („Pabarazitë e reduktuara“) dhe SDG 11 („Qytete dhe komuna të qëndrueshme“). Këtu janë të rëndësishme nën-objektivat e mëposhtme: Nën-objektivi 10.2: „Deri në 2030 të aftësohen të gjithë njerëzit [...] për të vetë-vendosur dhe të mxitet përfshirja e tyre sociale dhe ekonomike“
- Nën-objektivi 11.6: „Deri në 2030 të ulet ngarkesa për mjedisin që shkaktohet nga qytetet [...] me vëmendje të veçantë tek cilësia e ajrit [...]“

3.2. Fjalim: Ecuria organizative e fazës pilot

Eva Heuschen, SKEW

Eva Heuschen përmbledhi aspektet organizative dhe ecurinë kohore për pjesëmarrësit. *Memoranda of Understanding* formojnë bazën për bashkëpunimin me SKEW. SKEW këshillon që për një periudhë kohore afatmesme të nënshkruhet si shtesë edhe një marrëveshje ndërmjet komunave partnere ose të fillohet bashkëpunimi në lidhje me Axfordën 2030 në kontratat ekzistuese të partneriteteve ndërmjet qyteteve.

